



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 717/12 prot.

Datë 13.06.2024

V E N D I M
Nr. 681/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.06.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “INET” SHPK, në procedurën e prokurimit “E Hapur” me Nr. REF-92145-12-26-2023, me objekt “Platforma për aplikimet online, për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe”, me fond limit 24,686,667.00 (njëzet e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KREATX” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “INET” SHPK me NIPT K81607039F dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 3, Tiranë.

Operatori ekonomik “KREATX” SHPK me NIPT L12121023B dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr. 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen, për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.12.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-92145-12-26-2023, me objekt “Platforma për

aplikimet online, për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe”, me fond limit 24,686,667.00 (njëzet e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 11.01.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 29.01.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kreatx” SHPK	20,400,000	skualifikuar
2. “Inet” SHPK	21,000,000	skualifikuar
3. “Wow Digital” SHPK	22,190,000.30	skualifikuar
4. Image&Communication Development SHPK	23,451,200	skualifikuar
5. Prosound SHPK		pa ofertë ekonomike

II.4. Në datën 25.03.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar anulimin e procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 26.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 717/2024 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3920, e operatorit ekonomik “INET” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorit ekonomik “INET” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 717/2 prot., datë 27.03.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “INET” SHPK si vijon:

“[...]

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 2 e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumenteve të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

I. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik ka kërkuar:

“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më

të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”

Nga verifikimi i dokumentacionit ofertues të paraqitur në SPE nga Operatori ekonomik “INET” sh.p.k në përmbushje të kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik të DST, rezulton se ky i fundit ka paraqitur faturën tatimore nr. 21/ 2021 datë 27.09.2021, me subjektin privat “H.” sh.p.k, ku është cituar: “Shërbime zhvillim software Faza III sipas kontratës”, faturë kjo e cila nuk përmban elementët kryesorë të sigurisë dhe vlefshmërisë së saj (barcode përkatës).

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit dëshmuës në përmbushje të kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik të DST, rezulton se OE ofertues nuk ka paraqitur të dhëna të detajuara, në mënyrë që të bëhet krahasimi/vlerësimi nëse shërbimet janë të ngjashme dhe si rrjedhojë nuk mund të gjykohet mbi elementë ngjashmërie me shërbimet objekt kontrate duke iu referuar dokumentit të referencës së procedurës objekt vlerësimi, të cilat janë shërbime komplekse e voluminoze. Për të realizuar sistemin informatik “Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe” nëpërmjet të cilit synohet digjitalizimi i procesit të aplikimit, shqyrtimit, përzgjedhjes për regjistrim të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe nëpërmjet një platforme digjitale të dedikuar, me qëllim standartizimin dhe menaxhimin më profesional dhe më me efikasitet të proceseve të punës, pra nëpërmjet sistemit do të mundësohen

aplikime online, shqyrtim e vlerësim dokumentacioni nëpërmjet sistemit dhe deri tek njoftimi i aplikantëve fitues, operatori ekonomik do duhet të realizojë: zhvillime komplekse e integrimi të rëndësishme me sisteme të tjera të jashtme, para të cilave kërkohet të realizohet dhe një analizë e hollësishme e proceseve aktuale të punës në institucion; testime të funksionaliteve të sistemit objekt kontrate, shërbimet e instalimit të sistemit në infrastrukturën e AK si dhe duhet të garantojë disponueshmërinë e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të vazhdueshme sipas Marrëveshjes SLA të përcaktuar në dokumentin e termave të referencës, për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj pas dorëzimit përfundimtar të sistemit (duke filluar nga data e marrjes në dorëzim), konkretisht sipas fazave:

“Faza I –Faza përgatitore për sistemin/platformën.

Faza përgatitore është hapi më thelbësor në krijimin e një sistemi të suksesshëm. Gjatë kësaj faze do të duhet të realizohen: Ngritja dhe konfirmimi i grupeve të punës që do të jenë përgjegjës për zbatimin e kontratës/projektit. Planifikimi i burimeve njerëzore dhe materialeve të nevojshme për realizimin e projektit nga secila palë. Përcaktimi i hapave të zhvillimit dhe afateve konkrete kohore të tyre. Konfirmimi/detajimi i kërkesave kryesore të funksionaliteteve të sistemit në bashkëpunim me stafin e Bashkisë Tiranë. Analizim dokumentash. Referime në kuadrin ligjor. Vlerësimi i mundësive të ndryshme për përshtatjen e sistemit. Paraqitja në mënyrë skematike e proceseve të punës (workflow diagram).

Faza II – Faza e zhvillimit të sistemit / platformës o Ndërtimi i sistemit do të kalojë nëpër disa faza duke ju përmbajtur të gjithë standardeve të ndërtimit të një sistemi online. Gjatë kësaj faze, kontraktuesi do të vendosë në zbatim të gjithë informacionin e mbledhur dhe të analizuar gjatë fazës së parë. Kontraktuesi do të kryejë një përshtatje të plotë të platformës me proceset e krijuara në fazën e parë, duke ju përmbajtur të gjitha pikave të analizuarra dhe të miratuara. Nëse gjatë kësaj faze lind nevoja e ndryshimit të proceseve apo modeleve të krijuara, ky ndryshim do të kryhet i dokumentuar vetëm pasi të jetë marrë miratimi nga stafi i autorizuar i Bashkisë Tiranë. Përcaktimi i nevojave të infrastrukturës ku do bëhet hostimi i sistemit.

Faza III – Faza e integritimit dhe testimit të sistemit/platformës Gjatë kësaj faze do të realizohen: o Komunikimi me sistemin GIS të Bashkisë Tiranë Komunikimi me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile Gjatë kësaj faze gjithashtu do të kryhen testimet e sistemit. Do të jetë detyrë e stafit të autorizuar të Bashkisë Tiranë (komisionit) që të përcaktojë vlefshmërinë e proceseve, funksioneve dhe të sistemit në tërësi.

Faza IV –Trajnimi i përdoruesve Organizim i trajnimeve për përdoruesit fundorë dhe administratorët teknikë të sistemit. Dorëzimi i manualeve të përdorimit.

Faza VI- Dorëzimi Përfundimtar/ Marrja në dorëzim Instalimi i sistemit në infrastrukturën IT. Dorëzimi i sistemit. Pasi të gjithë proceset dhe funksionalitetet të jenë testuar dhe provuar dhe pasi të jetë realizuar dhe trajnimi i stafit, do të bëhet dorëzimi final i sistemit. Në dorëzimin final do të përfshihen të gjithë komponentët si dhe dokumentimi i të gjitha konfigurimeve përkatëse . Faza VII – Mirëmbajtje e sistemit Mirëmbajtja do të realizohet për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj pas marrjes në dorëzim të sistemit (duke filluar nga data e marrjes në dorëzim) me të gjithë komponentët përbërës.

Gjatë shërbimit të mirëmbajtjes, kontraktori duhet të kryejë azhurnime të sistemit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor kur ka ndryshime ligjore dhe proceduriale që hyjnë në fuqi, por jo vetëm. “I vetmi dokument i paraqitur në përmbushje të kriterit 2.3.1 të DST është fatuara tatimore pa elementët e domosdoshëm të sigurisë dhe ku është përshkruar vetëm “Shërbime zhvillim softëare Faza III sipas kontratës”, aq më tepër kur ndodhemi në mungesë totale

informacioni se cilat janë komponentët e FAZES III të kontratës në fjalë. KVO gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një ide të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës, kompleksitetit dhe volumit të saj AK, përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, dhe këta të fundit kanë barrën e provës dhe duhet të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për shërbimet që do të ofrojnë. Në vijim të arsytimit si më sipër, operatori ekonomik "INET" sh.p.k, nuk përmbush kriterin 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të DST dhe si rrjedhojë KVO konkludon njëzëri se OE "INET" sh.p.k skualifikohet.."

II.6. Në datën 31.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 755/2024 protokolli, datë 02.04.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3925, e operatorit ekonomik "Kreatx" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Kreatx" SHPK.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 755/2 prot., datë 02.04.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "Kreatx" SHPK si vijon:

"[...]"

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 82 pika 2 e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik të dokumentave standarde të tenderit ka kërkuar: "2.3.3 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 4 (katër) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

a) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.

b) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).

c) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).

d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.

e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente).

*Shënim 1: Certifikuar duhet të jenë të lëshuara nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

*Shënim 2: Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime. Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- Certifikata për specialistët e kërkuar
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (certifikimin, diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.
 - Listëpagesat sipas formularit e-Sig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Kriteri 2.3.3 dhe nënkomponentët e tij pika a, b, c, d, e do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. ”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “KREATX” sh.p.k, në përmbushje të kriterit 2.3.3 të Kapacitetit Teknik të dokumentave standarde të tenderit dhe konkretisht nga verifikimi i “Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit” të paraqitur, “Pjesa III Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, konstaton se Operatori Ekonomik “KREATX” sh.p.k, ka deklaruar: “[...] Kreatx shpk disponon të paktën 4 (katër) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Informatikë Ekonomike/ Mekatronike/ Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë.

Profili i punonjësve:

a) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.

b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.

c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente) ...”

Gjithashtu operatori ekonomik “KREATX” sh.p.k, në pikën B: DEKLARATË ”Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)”... “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik: ka deklaruar

Emri (at) e subjekteve: Bledar Mecu Person Fizik

NIPT-I : M2463100IT

Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik: Kapaciteti lidhur me kualifikimet arsimore dhe profesionale sipas parashikimeve ligjore. Specifiko konkretisht kapacitetin/et:

b) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).

c) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).

Në gjykim të deklaratave si më sipër, si elementë kyc në përmbushje të kriterit 2.3.3 të kapacitetit teknik, rezulton se OE "KREATX" sh.p.k, nuk i është përmbajtur kërkesave të këtij kriteri, konkretisht kushteve:"4 punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

f) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.

g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.

h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente).

Pra, OE ofertues nuk ka deklaruar sipas kërkesave të kriterit të sipërcituar stafin si më sipër , për të cilin duhet të plotësohen :

- (emër mbiemër) të stafit të angazhuar
- profilin e stafit të angazhuar (çertifikimin dhe diplomimin)
- Citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin staf të angazhuar
- Shënim 1: Certifikuar duhet të jenë të lëshuara nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Mosdeklarimi i informacioneve si më sipër, e bën të pamundur gjykimin mbi kualifikimet, diplomimet, çertifikimet, sipas kërkesave të kriterit të stafit që do të angazhohet në implementimin e kontratës, duke mbajtur në konsideratë faktin se punonjësit të cilët do të angazhohen në kontratë janë një nga elementët thelbësorë për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, dhe për më tepër mungesa e këtij informacioni do e bënte të pamundur vlerësimin e dokumentacionit Provues në momentin procedural "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/ enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar..."

Shënim:

Për sa i përket certifikimeve sipas pikave:

2.3.3/b) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).

2.3.3/c) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente). Për përmbushje të të cilave operatori ekonomik ofertues "Kreatx" sh.p.k ka deklaruar se do mbështetet në kapacitetet e operatorit ekonomik "Bledar Meco" PF, edhe pse ky i fundit nuk i ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 9, AK ka gjykuar mbi certifikatat e ngarkuara në SPE (edhe pse nuk është momenti i duhur procedural), konkretisht për "Certifikatën CISA "Certified Information System Auditors", Certifikatën CISA "Certified Information Security Manager", çertifikata të cilat përmbushin kërkesat e kriterit 2.3.3/b dhe 2.3.3/c. Në këtë këndvështrim e dhe në zbatim të neni 82, pika 2, gërma i, ku citohet se " "2.Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, reserve ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit”... KVO gjykon se kërkesat 2.3.3/b dhe 2.3.3/c të kriterit 2.3.3 konsiderohen të përmbushura. Në vijim të arsyetimit si më sipër, dhe në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku konkretisht në nenin 77 pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie [...]”

KVO konkludon se operatori ekonomik “KREATX” sh.p.k nuk përmbush kërkesat e kriterit 2.3.3 të DST pasi nuk dëshmon përmbushjen e kushteve:”

4 punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

f) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.

g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.

h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente). Përsa më sipër, OE “KREATX” sh.p.k , s’kualifikohet

II.7 Me anë të shkresës me nr. 717/4 prot., datë 03.05.2024 me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “INET” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II.8 Me anë të shkresës me nr. 17686/1 prot., datë 16.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 717/5 prot., datë 21.05.2024, me lëndë “Dërgim informacioni mbi trajtimin e ankesës së bërë nga operatori ekonomik “Inet” SHPK”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë informon Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “...është ndodhur përballë nevojës për kryerjen e verifikimit të faturës 21/2021 me të dhënat: Kodi 388, data dhe ora e lëshimit të faturës 27.09.2021 ora 11:24:40 NSLF: 10E5C779AAA5D57E8EFD26FB0853F81A, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Faturës Tatimore, nëpërmjet kërkesës nr. 14075 prot., datë 05.04.2024.

Për këtë arsye, është ndërprerë procesi i shqyrtimit të ankesës për të rifilluar pas marrjes së informacionit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Lidhur sa më sipër, është vënë në dijeni nëpërmjet emailit të dt 05.04.2024 edhe Komisioni i Prokurimeve Publike e administruara në dosjen e procedurës (bashkëlidhur kësaj shkrese). KSHA pas përfundimit të afatit 30 ditor për kthimin e përgjigjes si dhe ndodhur përpara faktit se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka kthyer asnjë përgjigje referuar kërkesës së sipërcituar, i është drejtuar me një shkresë tjetër me nr. 14075/1 datë 10.05.2024 me lëndë “Rikujtesë mbi kërkesën nr. 14075 prot., dt 10.05.2024” me anë të së cilës është kërkuar verifikimi dhe informimi sërish mbi vlefshmërinë tatimore të dokumentit me të dhënat më sipër. Autoriteti kontraktor aktualisht ndodhet në pritje të kësaj përgjigje. Mbas marrjes së këtij informacioni KSHA do të rivendoset në afatet e shqyrtimit të ankesës me qëllim trajtimin e saj dhe vënien më pas në dijeni të vendimit [...]”.

II.9. Me anë të shkresës Nr. 12929/5 prot., datë 24.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 717/6 prot., datë 28.05.2024, me objekt “Kthim – përgjigje ankesës së bërë nga operatori ekonomik “Inet” SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe me nr. REF-92145-12-26-2023”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik Inet SHPK nga ku rezulton, se e ka pranuar pjesërisht atë si vijon:

1.Referuar pretendimit të OE:

Operatori Ekonomik "Inet" sh.p.k ka paraqitur nëpërmjet S.P.E") dëshmine provuese Fature Elektronike Tatimore Nr.21/2021, me vlere 21,080,400 leke pa TVSH, me përshkrim malli/shërbimi Sherbime Zhvillim Softeare Faza III, sipas kontrates", me numer identifikues te veçantë te fatures NIVE). te shprehur si shenje alfanumerike (b98aa90b-0a76-40c7-901e-13c35e2abdce). per realizimin me sukses te kontratës ndaj blesit "H" sh.p.k për shërbimet analizë, zhvillim, integrim. testim, instalim, dorëzim, trajnimin e përdoruesve dhe mirëmbajtjen e sistemit, komponentë këto teknik dhe funksional te çdo platforme/sistemi bazuar në eeb. ge zhvillohet/ndërtohet sipas kërkesave te klientit/institucionit, referuar legjislacioneve dhe rregulloreve në fuqi. Fatura Elektronike Tatimore e paraqitur, permban të gjitha të dhënat e verifikueshme ne zbatim te Nenit 9 te Ligjit Nr. 87/2019 "Per Faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit". Siç janë: titulli "Fature tatimore", daten dhe kohen e lëshimit te fatures (oren, minutat dhe sekondat) numrin e Jatures, numrin unik te identifikimit të shitësit emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin e shitësit. adresen e shitësit, numrin unik të identifikimit të blesit emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresen e blesit, subjekt i TVSH-se ne perputhje me legjislacionin përkatës, kodin e operatori kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarise se biznesit sasine dhe përshkrimin e mallrave ose te sherbimeve të furnizuara,

vlerën totale, shkallën e aplikuar të TVSH-së dhe numrin identifikues të veçantë të fatures (NIVF), të shprehur si shenjë alfanumerike (698aa90b-0a76-40c7-901e-13c35e2abdce) dhe numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF), të shprehur si shenjë alfa numerike, elementë që verifikojnë vërtetësinë e dokumentit provues të paraqitur [...].

KSHA arsyeton:

Për të verifikuar vlefshmërinë e faturës mbi të cilën Operatori Ekonomik ka shprehur pretendimin se përmban të gjithë elementët e verifikueshëm në zbatim të Nenit 9 të Ligjit Nr. 87/2019 "Per Faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit", KSHA i është drejtuar për verifikimin e faturës objekt ankimimi, Drejtorisë së Përgjithme të Tatimeve me anë të kërkesës nr. 14075 prot., datë 05.04.2024 me objekt "Kërkesë për verifikim dokumentacioni". Në mungesë të përgjigjes referuar kërkesës së sipërcituar KSHA ka ridërguar kërkesën nr. 14075/1 prot., datë 10.05.2024 me objekt "Rikujtesë mbi kërkesën nr. 14075 prot., datë 05.04.2024" (bashkëlidhur).

Në përgjigje të sa më sipër, pranë autoritetit kontraktor ka ardhur përgjigja nr. 6223/1 prot., datë 5.2024, hyre ketu me date 15.05.2024 nr. 14075/2 prot., në të cilën citohet se fatura nr. 21/2021 gie te sa me siper, prane Autoritetit Kontraktor ka ardhur përgjigja nr. 6223/1 prot., date 27.09.2021 rezulton të jetë e deklaruar saktë nga ana e të dy subjekteve në sistemin tatimor

Referuar sa më sipër, K.SH.A givkon, se pretendimi i Operatorit Ekonomik "Inet" sh.p.k lidhur me vlefshmërinë e faturës elektronike nr 21/2021, qendron.

Referuar pretendimit të OE:

"[...] Ofertuesi "Inet" sh.p.k ka permbushur plotësisht pikën b)/2.3 Kapaciteti teknik të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, me paraqitjen e dokumentit provues Fature Tatimore Shitje Nr.21/2021, me vlere 21.080,400 leke pa TVSH, e cila vërtëton shërbimin e kompletuar kompleks të zhvillimit të softuerit/platformes (analizen, programimin/kodimin, testimin, zbatimin, trajnimin dhe mirëmbajtjen SLA), që i ngjason natyrës së zhvillimit të platformës objekt-kontratë prokurimi dhe të gjitha qëllimeve të përgjithshme dhe specifike të detyrave (KPIs) percaktuar në Termat e Reference se DT objekt prokurim, ky sqarohet qartë që AK prokuron shërbimin e zhvillimit të një platforme të posçame. Theksojmë që: çdo operator ekonomik që dëshmon përvojën dhe aftësinë teknike të ndërtoje/zhvillojë një platformë/software të personalizuar në vlera të ngjashme financiare, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor/Klientit dëshmon që ka eksperiencën dhe aftësinë për të ngritur/zhvilluar një sistem me të gjitha kompleksitetet teknike, financiare dhe funksionale në teknologjinë, me të cilën do ndërtohet sistemi objekt-kontrate

KSH arsyeton:

Bazuar në Shtojcën 7 "Formulari i Termave të Referencës" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, konkretisht për procedurën me objekt "Platforma për aplikimet online për regjistrimin e femijëve në kopshte dhe çerdhe", rezulton se autoriteti kontraktor ka si objektiv të përgjithshëm sigurimin e një platforme informatike që do të digjitalizojë procesin

për aplikimin, shqyrtimin. përzgjedhjen e fëmijëve për t'u regjistruar në Kopshtet dhe Çerdhet e Bashkisë Tiranë.

"[...] Pra nga verifikimi i dokumentit të Termave të Referencës janë të detajuara shërbimet e kërkuara, nëpërmjet fazave, ku kërkohen integritet me rregjistrin kombëtar të gjendjes civile i cili është në rrjetin (gov.net), sistemin GIS të BT. testimet e sistemit, trajnime për përdoruesit fundor dhe administrator teknikë të sistemit, instalim të tij në Infrastukturën e AK si dhe mirëmbajtja e sistemit për një periudhë 24 (njetetë e katër) muaj pas marrjes në dorëzim të sistemit (duke filluar nga data e marrjes në dorëzim me të gjithë komponentët përbërës sipas SLA të përcaktuar.

Referuar sa më sipër, KSHA gjykon se kemi të bëjmë me një projekt specifik për sa i përket natyrës së sistemit, objekt prokurimi. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Inet" sh.p.k, KSHA vëren se për përmbushjen e kriterit 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të dokumentave standarde të tenderit Operatori Ekonomik ka dorëzuar Faturën tatimore nr. 21/2021 me përshkrimin "Shërbime zhvillim softëare Faza III sipas kontratës". Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë që shërbimi/malli është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Operatorët Ekonomik ofertues marrin përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike, në mënyrë që të kryhet me lehtësi vlerësimi i tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit të ofertuar, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e shërbimeve/mallrave dorëzuar granton përputhshmerinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në dst

Bazuar në zërin e cituar në faturën nr. 21/2021, parë në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor dhe natyrës së procedurës së prokurimit, KSHA gjykon se Operatori Ekonomik nuk faktori tërësinë e shërbimeve të ngjashme me sistemin, objekt kontrate të tilla si:

- Sistem që mundëson aplikime online dhe ndjekjen (follow up) të tyre.
- Realizim trajnimesh
- Realizime integrimi me sisteme të tjera.
- Realizime testimesh
- Realizime të shërbimeve të mirëmbajtjes.

[...].Thënë kjo gjykojmë se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize sipërfaqësore, por operatori ekonomik në momentin e paraqitjes së ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë elementët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit për të zbatuar kontratën.

Në vijim të gjykimit, në argumentin mbi shkëljet e pretenduara, në të cilën citohet se ... "Ofertuesi "Inet" sh.p.k ka përmbushur plotësisht pikën b)/2.3 Kapaciteti teknik të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, me paraqitjen e dokumentit provues Faturë Tatimore Shitje Nr.21/2021, me vlerë 21,080,400 lekë pa TVSH. e cila vërteton shërbimin e kompletuar kompleks të zhvillimit të softuerit/platforms (analizën, programimin/kodimin, testimin, zbatimin, trajnimin dhe mirëmbajtjen SLA), që i ngjason natyrës së zhvillimit të platformës

objekt-kontratë prokurimi dhe të gjitha qëllimeve të përgjithshme dhe specifike të detyrave (KPIs) përcaktuar në Termat e Referencë së DT objekt prokurim....", ritheksojmë se nga verifikimi i dokumentit të paraqitur për përmbushjen e kriterit të shërbimeve të ngjashme, nuk faktohet asnjë shërbim konkret i realizuar si analiza, testimi, zbatimi, trajnimi apo mirëmbajtja SLA, për sisteme të ngjashme me objektin e procedurës "Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe". Referuar arsytimit, për të faktuar atë cka Operatori Ekonomik "Inet" sh.p.k pretendon, barra e provës i mbetet këtij të fundit në fazën e hapjes së procedurës për vlerësim.

Në përmbyllje të arsytimit për këtë pikë, K.SHA konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjithë elementëve duke nisur nga shërbimet e kërkuara objekt kontrate si dhe nga përshkrimi i zërit të faturës, Operatori Ekonomik "Inet" sh.p.k nuk ka dorëzuar dëshmi se ka realizuar shërbime të ngjashme me kontratën, objekt ankimi.

Pretendimi të OE:

Gjithashtu në argumentim ekonomik vlera prej 21,080,400 lekë pa TVSH e dokumentit provues Fanure Elektronike Tatimore Nr.21/2021 date 27.09.2021, perben 85% të vlerës së fondit kontrates së prokuruar dhe duhet të shërbente Autoritetit/Entitetit Kontraktor si prove e vlefshme e limit të sh.p.k, për gjykimin e saktë të faktit financiar dhe teknologjik të ngjashëm Përvojës së O.E Ine okumenti provues shpreh qartë përshkrimin dhe fushëveprimin e përvojës e mëparshme të ngjashme me platformën objekt-kontratë prokurimi..”

KSHA arsyeton:

Na zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"(i ndryshuar) citohet specifikisht:

"Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per të vertetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fugi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fugi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i arsyes së skualifikimit K.SH.A vëren se në asnjë moment nuk citohet si motiv skualifikimi vlera financiare e faturës elektronike 21/2021 dhe si rrjedhojë ky pretendim nuk qëndron [...].

Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, K.SH.A gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nuk është ne përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Autoriteti Kontraktor duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në gimin e kontrates dhe dokumentet e tenderit dhe në rastin konkret, K.SH.A vlerëson se fatura e aragitur në procedurën e prokurimit nuk plotëson kërkesat e përcaktuara të kriterit 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të DST në lidhje me dëshminë e shërbimeve të ngjashme konform përcaktimeve të këtij kriteri.

Konkluzionet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, arrin në konkluzion se:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "INET" sh.p.k qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114 pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenit 102 pika 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

VENDOSI:

I. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "INET" sh.p.k për procedurën e prokurimit me objekt: "Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe" me Nr. REF-92145-12-26-2023 [...].

II.10. Me shkresën me nr. 12929/3 prot., datë 15.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 755/3 prot., datë 17.04.2024, me lëndë "Kthim - përgjigje ankesës së bërë nga operatori ekonomik "Kreatx" SHPK, për procedurën e prokurimit me objekt: "Platforma për aplikimet online, për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe" me nr. REF-92145-12-26-2023", autoriteti kontraktor ka dorëzuar akin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik "Kreatx" SHPK nga ku konstatohet se e ka refuzuar atë si më poshtë vijon:

[...] KSHA nga verifikimi i dokumentit të Formularit të Vetëdeklarimit dorëzuar nga KREATX shpk vëren se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat sipas kriterit 2.3.3 të DST për stafin e kërkuar dhe konkretisht "Deklarimin nga operatori ekonomik të stafit të angazhuar (emër, mbiemër), profilin e tyre (certifikimin, diplomimin) citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre".

Mbështetur në nenin 26 pika 2 gërma h e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), është shprehur qartësisht se operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti) dhe rrjedhimisht një ndër kërkesat e AK për përmbushjen e këtij kriteri është deklarimi nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit i të dhënave emër, mbiemër certifikimi, diplomimi, citimi i dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej punonjësve.

Nga verifikimi i deklaratës së operatorit ekonomik “Kreatx” vihet re se ka dëshmuar se ka në stafin e tij punonjës të diplomuar në shkenca elektronike/teknologji informacioni/informatikë/informatikë ekonomike/mekatronike/telekomunikacion) si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

Profili i punonjësve:

- a) Të paktën 1(një) punonjës të certifikuar për menaxhim projekti (PMP ose ekuivalente) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.
- b) Të paktën një punonjës të certifikuar si testues sistemesh
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do të ndërtohet sistemi objekt kontrate ose ekuivalent.

Për sa më sipër, operatori ekonomik duke mos deklaruar këto të dhëna (emër, mbiemër) profilin e tyre (certifikim, diplomim), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre”, nuk ka përmbushur kërkesat sipas kriterit të hartuar nga AK në dokumentet e tenderit, detyrim ky për tu përmbushur në këtë moment procedural, gjithashtu e bën të pamundur vlerësimin e dokumentacionit provues në momentin procedural përpara “përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit [...]

Në përmbyllje të gjykimit, KSHA thekson se mosplotësimi qoftë dhe i një kriteri të vendosur nga ana autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit për stafin që do të angazhohet në impementimin e kontratës objekt ankimimi, KSHA gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjithë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit dhe në rastin konkret, plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit jo në përputhje me kriteret e hartuara nga autoriteti kontraktor, përbën kusht për skualifikim.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK nuk qëndron [...].

[...] për sa më sipër në mbështetje të nenit 114 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 102 pika 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

VENDOSI

1. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt “Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshe dhe çerdhe”, me nr. Ref-92145-12-26-2023 [...]”.*

II.11 Me anë të shkresës me nr. 717/7 prot., datë 31.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik me kërkesën për informacion si vijon:

“[...] Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor Komisioni konstaton se në datë, 25.03.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar anulimin e procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “INET” SHPK, si dhe ankesës së operatorit ekonomik ankimue “Kreatx” SHPK, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet e nevojshme kryerja e verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik. KPP konstaton se procedura e prokurimit “E Hapur” me Nr. REF-92145-12-26-2023, me objekt “Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe” me fond limit 24,686,667.00 (njëzet e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk shfaqet në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës së operatorëve ekonomik ankimues, kërkojmë nga ana juaj, të riktheni në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) procedurën e mësipërme të prokurimit publik”.

II.12 Me shkresën me nr. 717/8 prot., datë 31.05.2024, me lëndë “Vënie në dijeni”, Komisioni i Prokurimit Publik ka vënë në dijeni autoritetin kontraktor Bashkia Tiranë, si dhe operatorin ekonomik “Inet” SHPK dhe “Kreatx” SHPK, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.13 Me shkresën me nr. 4124/1 prot., datë 10.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 717/9 prot., datë 11.06.2024, me lëndë “Kthim - përgjigje”, Agjencia e Prokurimit Publik informon mbi hapat e ndërmarra për kthimin e procedurës në SPE.

II.14. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, të cilat nuk janë sipas formularit standard për paraqitjen e argumenteve.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inet” SHPK mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Referuar shkresës Nr.12929/5 prot., datë 24.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 717/6 prot., datë 28.05.2024, me objekt “Kthim – përgjigje ankesës së bërë nga operatori ekonomik “Inet” shpk në procedurën e prokurimit me objekt: “Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe me nr. REF-92145-12-26-2023””, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Inet” SHPK, nga ku rezulton, se e ka pranuar pjesërisht atë si vijon:

1.Referuar pretendimit të OE:

Operatori Ekonomik "Inet" sh.p.k ka paraqitur nepërmjet S.P.E") dëshmine provuese Fature Elektronike Tatimore Nr.21/2021, me vlerë 21,080,400 leke pa TVSH, me përshkrim malli/shërbimi Sherbime Zhvillim Softëare Faza III, sipas kontrates", me numer identifikues të veçantë të fatures NIVE). të shprehur si shenjë alfanumerike (b98aa90b-0a76-40c7-901e-13c35e2abdce). për realizimin me sukses të kontratës ndaj blerësit "H" sh.p.k për shërbimet analizë, zhvillim, integrim, testim, instalim, dorëzim, trajnimin e përdoruesve dhe mirëmbajtjen e sistemit, komponentë këto teknik dhe funksional të çdo platforme/sistemi bazuar në eeb. që zhvillohet/ndërtohet sipas kërkesave të klientit/institucionit, referuar legjislacioneve dhe rregulloreve në fuqi. Fatura Elektronike Tatimore e paraqitur, përmban të gjitha të dhënat e verifikueshme në zbatim të Nenit 9 të Ligjit Nr. 87/2019 "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit". Siç janë: titulli "Fature tatimore", datën dhe kohën e lëshimit të fatures (oren, minutat dhe sekondat) numrin e fatures, numrin unik të identifikimit të shitësit emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin e shitësit. adresën e shitësit, numrin unik të identifikimit të blerësit emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit, subjekt i TVSH-se në përputhje me legjislacionin përkatës, kodin e operatori kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit sasine dhe përshkrimin e mallrave ose të shërbimeve të furnizuara, vlerën totale, shkallën e aplikuar të TVSH-së dhe numrin identifikues të veçantë të fatures (NIVF), të shprehur si shenjë alfanumerike (698aa90b-0a76-40c7-901e-13c35e2abdce) dhe numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF), të shprehur si shenjë alfa numerike, elementë që verifikojnë vërtetësinë e dokumentit provues të paraqitur.

Në informim të Autoritetit Kontraktor i cili pretendon që Fatura Tatimore Nr.21/ 2021 date 27.09.2021, me subjektin privat “H.” sh.p.k, me përshkrim “Shërbime zhvillim softëare Faza III sipas kontrates”, nuk përmban elementet kryesore të sigurisë dhe vlefshmerisë së saj (barcode përkatës), sjellim në vëmendje përkufizimin e Nenit 3 të Ligjit Nr. 87/2019 "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit", pika m) "Kodi OR" është: një barkod dydimensional i përgjigjes së shpejtë, që përdoret për të aksesuar në mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë informacionin, ndërkohë që të gjitha elementet kryesorë, përfshirë numrin e sigurisë në zbatim të Ligjit Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit, janë të verifikueshme në faturën elektronike tatimore të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik

Gjithashtu, fatura tatimore Nr.21/2021 datë 27.09.2021, është e regjistruar rregullisht në Platforma Qendrore e Faturave e Administratës Tatimore (<https://efiskalizimi->

app.tatime.gov.al) dhe është e verifikueshme lehtësisht në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore, për më tepër AK, në parashikim të Nenit 92 dhe pa cënuar dispozitat e Ligji Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", për një vlerësim sa më të drejtë të ofertës së paraqitur, mund ta shikonte të arsyshme të kërkonte një sqarim mbi faturën e paraqitur apo ta verifikonte atë në bazën e të dhënave....

KSHA arsyeton:

Për të verifikuar vlefshmërinë e faturës mbi të cilën Operatori Ekonomik ka shprehur pretendimin se përmban të gjithë elementët e verifikueshëm në zbatim të Nenit 9 të Ligjit Nr. 87/2019 "Per Faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit", KSHA i është drejtuar për verifikimin e faturës objekt ankimit, Drejtorisë së Përgjithme të Tatimeve me anë të kërkesës nr. 14075 prot., datë 05.04.2024 me objekt "Kërkesë për verifikim dokumentacioni". Në mungesë të përgjigjes referuar kërkesës së sipërcituar KSHA ka ridërguar kërkesën nr. 14075/1 prot., datë 10.05.2024 me objekt "Rikujtesë mbi kërkesën nr. 14075 prot., datë 05.04.2024" (bashkëlidhur).

Në përgjigje të sa më sipër, pranë autoritetit kontraktor ka ardhur përgjigja nr. 6223/1 prot., datë 5.2024, hyre ketu me date 15.05.2024 nr. 14075/2 prot., në të cilën citohet se fatura nr. 21/2021 gie te sa me siper, prane Autoritetit Kontraktor ka ardhur përgjigja nr. 6223/1 prot., date date 27.09.2021 rezulton të jetë e deklaruar saktë nga ana e të dy subjekteve në sistemin tatimor

Referuar sa më sipër, K.SHA givkon se pretendimi i Operatorit Ekonomik "Inet" sh.p.k lidhur me vlefshmërinë e faturës elektronike nr 21/2021, qendron.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1, 2 dhe 3 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët

ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Sa më sipër, KPP do të mbyllë shqyrtimin, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, që rezultojnë se janë pranuar nga autoriteti kontraktor, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime.

III.2. Lidhur pretendimin e operatorit ekonomik "Inet" SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: "[...]Fatura Elektronike Tatimore Nr.21/2021, me vlere 21,080,400 leke pa TVSH, me përshkrim malli/shërbimi Sherbime Zhvillim Softeare Faza III, sipas kontrates", me numer identifikues te veçantë te fatures NIVE). te shprehur si shenje alfanumerike (b98aa90b-0a76-40c7-901e-13c35e2abdce). per realizimin me sukses te kontratës ndaj bleresit "H" sh.p.k për shërbimet analizë, zhvillim, integrim. testim, instalim, dorëzim, trajnimin e përdoruesve dhe mirëmbajtjen e sistemit, komponentë këto teknik dhe funksional te çdo platforme/sistemi bazuar në eeb. qe zhvillohet/ndërtohet sipas kërkesave te klientit/institucionit, referuar legjislacioneve dhe rregulloreve në fuqi. Fatura Elektronike Tatimore e paraqitur, permban të gjitha të dhënat e verifikueshme ne zbatim te Nenit 9 te Ligjit Nr. 87/2019 "Per Faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit". Siç janë: titulli "Fature tatimore", daten dhe kohen e lëshimit te fatures (oren, minutat dhe sekondat) numrin e Jatures, numrin unik te identifikimit të shitësit emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin e shitesit. adresen e shitësit, numrin unik të identifikimit të bleresit emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresen e blerësit, subjekt i TVSH-se ne perputhje me legjislacionin përkatës, kodin e operatori kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarise se biznesit sasine dhe përshkrimin e mallrave ose te sherbimeve të furnizuara, vlerën totale, shkallën e aplikuar të TVSH-së dhe numrin identifikues te veçantë të fatures (NIVF), të shprehur si shenje alfanumerike (698aa90b-0a76-40c7-901e-13c35e2abdce) dhe numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës

(NSLF), të shprehur si shenjë alfa numerike, elementë që verifikojnë vërtetësinë e dokumentit provues të paraqitur.

Ne informim të Autoritetit Kontraktor i cili pretendon që Fatura Tatimore Nr.21/ 2021 date 27.09.2021, me subjektin privat "H." sh.p.k, me përshkrim "Shërbime zhvillim softëare Faza III sipas kontrates", nuk përmban elementet kryesore të sigurisë dhe vlefshmerisë së saj (barcode përkatës), sjellim në vëmendje përkufizimin e Nenit 3 të Ligjit Nr. 87/2019 "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit", pika m) "Kodi QR" është: një barkod dydimensional i përgjigjes së shpejtë, që përdoret për të aksesuar në mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë informacionin, ndërkohë që të gjitha elementet kryesorë, përfshirë numrin e sigurisë në zbatim të Ligjit Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit, janë të verifikueshme në faturën elektronike tatimore të ngarkuar në sitimin e prokurimit elektronik.

Gjithashtu, fatura tatimore Nr.21/2021 datë 27.09.2021, është e regjistruar rregullisht në Platforma Oëndrore e Faturave e Administratës Tatimore (<https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al>) dhe është e verifikueshme lehtësisht në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore, për më tepër AK, ne parashikim të Nenit 92 dhe pa cënuar dispozitat e Ligji Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", për një vlerësim sa më të drejtë të ofertës së paraqitur, mund ta shikonte të arsyshme të kërkonte një sqarim mbi faturën e paraqitur apo ta verifikonte atë në bazën e të dhënave.

Ofertuesi Inet SHPK deklaron, se ka përmbushur plotësisht pikën b) 2.3 kapaciteti teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit, me paraqitjen e dokumentit provues faturë tatimore shitje nr. 31/1021, me vlerë 21,080,400 lekë pa tvsh e cila vërteton shërbimin e kompletuar kompleks të zhvillimit të softuerit/platformës (analizën, programimin, kodimin, testimin, zbatimin, trajnimin dhe mirëmbajtjen SLA) që i ngjason natyrës së zhvillimit të platformës objekt kontratë prokurimi dhe të gjitha qëllimeve të përgjithshme dhe specifike të detyrave (KPIs) përcaktuar në termat e referencës së DT objekt prokurimi, ku sqarohet qartë se AK prokuron shërbimin e zhvillimit të një platforme të posaçme....Gjithashtu, në argumentim ekonomik vlera prej 21.080.100 lekë pa tvsh e dokumentit provues faturë elektornike tatimore nr. 21/2021 datë 27.09.2021 përbën 85 % të vlerës së fondit limit të kontratës së prokuruar dhe duhet ti shërbente autoritetit/entit kontraktor si provë e vlefshme e përvojës së OE Inet SHPK, për gjykimin e saktë të faktit financiar dhe teknologjik të ngjashëm, pasi dokumenti provues shpreh qartë përshkrimin dhe fushëveprimin e përvojës së mëparshme të ngjashme me platformën objekt - kontratë prokurimi. [...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.1 "Kapaciteti Teknik", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.2.2 Në shtojcën 7 “Termet e referencës”, të dokumenteve standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 7

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

”Platforma për aplikimet online për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe”

Objektivi i Përgjithshëm: Objektivi kryesor i kësaj kontratë është sigurimi i një platforme informatike që do të digjitalizojë procesin për aplikimin, shqyrtimin, përzgjedhjen e fëmijëve për t’u regjistruar në Kopshtet dhe Çerdhet e Bashkisë Tiranë.

1.1. Qëllimi

Nëpërmjet kësaj kontrate, autoriteti kontraktor synon:

- *Digjitalizimin e procesit të aplikimit, shqyrtimit, përzgjedhjes për regjistrim të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe nëpërmjet një platforme digjitale të dedikuar, me qëllim standartizimin dhe menaxhimin më profesional dhe më me efikasitet të proceseve të punës.*
- *Përmirësimin cilësor të zhvillimit të procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes së fëmijëve në kopshte dhe çerdhe, nëpërmjet sigurimit të një platforme të përshtatshme të digjitalizuar.*
- *Automatizim maksimal të proceseve për të patur një zgjidhje finale të një sistemi që përfshin të dhënat mbi objektivat e planifikuara, realizimet dhe të dhënat operationale përkatëse.*
- *Përmirësimi i efikasitetit të gjithë procesit dhe dhënies së shërbimit në një kohë sa më të shpejtë për grupet e synuara.*

- *Transparencë në të gjitha hallkat e përfshira në këtë proces dhe mundësi evidentimi problematikash për t'i adresuar në kohë.*
- *Saktësi e informacionit dhe akses në çdo kohë i të dhënave mbi aplikantët.*
- *Koordinimin dhe lehtësi në procesin e përzgjedhjes së fëmijëve, nisur nga rastet më me prioritet sipas kriterëve të përzgjedhjes konform legjislacionit në fuqi.*

Termet e referencës, të plota ndodhen bashkalidhur DST

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se operatori ekonomik “Inet” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Faturë tatimore nr. 21/2021, datë 27.09.2021, me objekt “Shërbime zhvillimi softëare Faza III e kontratës”, me vlerë 21 080 400 lekë pa tvsh.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.7. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

III.2.8. Në nenin 41, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u

përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.10. Referuar shtojcës 7 “Termave të Referencës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për projektin me objekt “Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe në çerdhe”, rezulton se autoriteti kontraktor kërkon sigurimin e një platforme informatike që do të digjitalizojë procesin për aplikimin, shqyrtimin, përzgjedhjen e fëmijëve, për t'u regjistruar në Kopshtet dhe Çerdhet e Bashkisë Tiranë. Nëpërmjet këtij projekti synohet digjitalizimi i procesit të aplikimit, shqyrtimit, përzgjedhjes për regjistrim të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe nëpërmjet një platforme digjitale të dedikuar, me qëllim standartizimin dhe menaxhimin më profesional dhe më me efikasitet të proceseve të punës, përmirësimin cilësor të zhvillimit të procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes së fëmijëve në kopshte dhe çerdhe, nëpërmjet sigurimit të një platforme të përshtatshme të digjitalizuar, automatizimi maksimal i proceseve, për të pasur një zgjidhje finale të një sistemi që përfshin të dhënat mbi objektivat e planifikuara, realizimet dhe të dhënat operacionale përkatëse, përmirësimi i efikasitetit të gjithë procesit dhe dhënies së shërbimit në një kohë sa më të shpejtë për grupet e synuara, transparencë në të gjitha hallkat e përfshira në këtë proces dhe mundësi e evidentimit të problematikash për t'i adresuar në kohë, saktësi e informacionit dhe akses në çdo kohë i të dhënave mbi aplikantët, koordinimin dhe lehtësi në procesin e përzgjedhjes së fëmijëve, nisur nga rastet më me prioritet sipas kriterëve të përzgjedhjes konform legjisllacionit në fuqi. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Inet” SHPK në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP vëren, se operatori ekonomik në

përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me shërbimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “Inet” SHPK, ka dorëzuar një faturë tatimore të realizuar me subjekte private, konkretisht fatura tatimore nr. 21/2021, datë 27.09.2021, me objekt “Shërbim Zhvillimi software, Faza III, sipas kontratës”, me vlerë totale 21 080 400 lekë pa TVSH.

Referuar termave të referencës së shërbimeve të kerkuara dhe të përcaktuara në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, KPP konstaton, se ndër të tjera është sqaruar se: *“Objektivi kryesor i kësaj kontratë është sigurimi i një platforme informatike që do të digjitalizojë procesin për aplikimin, shqyrtimin, përzgjedhjen e fëmijëve për t’u regjistruar në Kopshtet dhe Çerdhet e Bashkisë Tiranë. Nëpërmjet kësaj kontrate, autoriteti kontraktor synon: Digjitalizimin e procesit të aplikimit, shqyrtimit, përzgjedhjes për regjistrim të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe nëpërmjet një platforme digjitale të dedikuar. Rezultatet e pritshme që duhet të arrihen nga Kontraktori në kuadër të kësaj kontrate do të jenë: Kontraktori duhet të implementojë një platformë informatike që plotëson kërkesat dhe funksionalitetet e paraqitura në këtë dokument. Kontraktori duhet të konfirmojë bashkarisht me Bashkinë Tiranë funksionet që do përmbajë sistemi bazuar në objektivat e kontratës; Kontraktori do të zhvillojë sistemin për nevojat e Bashkisë Tiranë, do ta testojë atë në bashkëpunim me përdoruesit dhe do ta përgatisë për instalim në infrastrukturën përkatëse. Kontraktori, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë duhet të mundësojë trajnimin e punonjësve (stafin teknik dhe përdoruesit fundorë) në lidhje me përdorimin e sistemit; Përfundimi i instalimit të sistemit/platforme pranë Bashkisë Tiranë; Mirëmbajtja për 24 (njëzet e katër) muaj pas marrjes në dorëzim të sistemit.*

Në rastin konkret, KPP gjykon, se kemi të bëjmë me një projekt specifik, jo vetëm për sa i përket objektit të tij, por edhe natyrës së shërbimeve të kerkuara. Në këtë mënyrë, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me ngritjen e një platforme informatike që do të digjitalizojë procesin aplikimin, shqyrtimin, përzgjedhjen e fëmijëve për t’u regjistruar në Kopshtet dhe Çerdhet e Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, referuar termave të referencës, do të duhet që sistemi të ndërveprojë me disa sisteme të tjera përkatësisht, komunikimi me sistemin GIS të Bashkisë Tiranë, komunikimi me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Sistemi duhet të ofrojë mundësi integrimi me sistemet e tjera të vetë bashkisë apo institucioneve të tjera qeveritare siç është Sistemi i Çelësave Publik (duke suportuar mundësi komunikimi nëpërmjet WEB API). Ngritja e kësaj platforme do të kalojë në disa faza përkatësisht, Faza I –Faza përgatitore për sistemin/platformën, Faza II – Faza e zhvillimit të sistemit/platformës , Faza III – Faza e integritit dhe testimit të sistemit/platformës, Faza IV –Trajnimi i përdoruesve, Faza VI- Dorëzimi Përfundimtar/ Marrja në dorëzim, Faza VII – Mirëmbajtje e sistemit.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve*

ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”, KPP vlerëson, se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për shërbime publike ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e dëshmimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i shërbimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Lidhur me faktin nëse fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik “INET” SHPK plotëson apo jo kriterin kualifikues të shërbimeve të ngjashme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se fatura tatimore nr. 21/2021, datë 27.09.2021, me objekt “Shërbime zhvillim software Faza III sipas kontratës”, me vlerë 21 080 400 lekë TVSH, është e vlefshme për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pasi fatura është lëshuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data 27.12.2023 e publikimit të njoftimit të kontratës. Lidhur me komponentin e ngjashmërisë së faturës tatimore të dorëzuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Inet” SHPK me faturën e dorëzuar ka dhënë indicie që ka kryer shërbime të ngjashme, pasi objekti i faturës së dorëzuar është “Shërbim zhvillim software Faza 3 sipas kontratës”, akoma më tej për sa i përket vlerës së faturës tatimore të dorëzuar nga operatori ekonomik “Inet” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se fatura nr. 21/2021, datë 27.09.2021, me vlerë totale 21 080 400.00 lekë pa TVSH, përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, konkretisht vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka dhënë indicie që përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 2.3.1 shtojcës 8, të dokumenteve të tenderit.

Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues me arsyen, se..... *OE ofertues nuk ka paraqitur të dhëna të detajuara, në mënyrë që të bëhet krahasimi/vlerësimi nëse shërbimet janë të ngjashme dhe si rrjedhojë nuk mund të gjykohet mbi elementë ngjashmërie me shërbimet objekt kontrate duke iu referuar dokumentit të referencës së procedurës objekt vlerësimi, të cilat janë shërbime komplekse e voluminoze,* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “ *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, autoriteti kontraktor nëse kishte dyshime, apo pamundësi për të verifikuar dokumentin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konkretisht faturës tatimore nr. 21/2021, datë 27.09.2021, duhet t’i kërkonte sqarime operatorit ekonomik “Inet” SHPK.

Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kualifikojë operatorin ekonomik “INET” SHPK, si dhe t’i kërkojë sqarime lidhur me faturën tatimore nr. 21/2021, datë 27.09.2021, me objekt “Shërbim zhvillim software Faza 3 sipas kontratës”, të dorëzuar nga operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.1, shtojcës 8, të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “*Vlerësojmë se përpara se AK të skualifikonte shoqërinë Kreatx shpk duhej më parë ti kishte kërkuar kësaj të fundit dokumentacionin përkatës për të provuar përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe jo të procedojë menjëherë me skualifikimin e saj[...].*

[...]Në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronja h) për të përcaktuar nëse operatori ekonomik përmbushte kriteret e veçanta të kualifikimit apo jo dhe në këtë mënyrë AK ka shkëlur një nga hapat kryesore proceduriale të përcaktuara në ligj...Komisioni i Prokurimeve Publike si organi

më i lartë vendimmarrës në procedurat e prokurimit publik e ka shprehur disa herë qëndrimin e saj në më shumë vendime të tjera unifikuese për këtë situatë juridike, si për shembull vendimi nr. 59/2023, datë 26.01.2023, vendimi nr. 683/2023 datë 27.07.2023, në të cilat midis të tjerave është pasqyruar komunikimi shkresor që KPP ka patur në APP në lidhje me mënyrën e plotësimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të hapësira “profili i punonjësve”. Më konkretisht ky raportim zyrtar konsiston si më poshtë:

III.1.12 Me shkresën nr. 2472/4 prot., datë 10.01.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik me kërkesën për sqarim me përmbajtje si më poshtë: [...]Konkretisht KPP gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave, ka konstatuar në shtojcën nr. 8 të dokumenteve të tenderit për procedurat e prokurimit mallra, Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes Kualifikimit pika B. Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme nëse kërkohen”. Për më sipër referuar, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja për sqarim mbi qëllimin dhe sasinë e të dhënave, që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë në këtë deklaratë. Në këto kushte Komisionit i nevojitet një sqarim nga ana juaj konkretisht në lidhje me të dhënat, që duhet të pasqyrojnë operatorët ekonomikë në lidhje me të dhënat tek hapësira “profili i punonjësve” - Në këtë hapësirë është i detyrueshëm vetëm pasqyrimi i profilit të punonjësve apo dhe të dhënat mbi punonjësit?...III.1.13 Me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022, protokolluar me tonën me nr. 2472/5 prot., 21.01.2022 Agjencia e Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: “..Kriteri për kualifikim mbi disponimin, duhet të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 8 të dst. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme“, në këtë shtojcë është garantimi i ekzekutimit të kontratës sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në një procedurë prokurimi [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3, “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.3 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 4 (katër) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informatiçi/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.

e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente).

***Shënim 1: Certifikuar duhet të jenë të lëshuara nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.**

***Shënim 2 : Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.**

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- Çertifikata për specialistët e kërkuar
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (çertifimin, diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.
- Listëpagesat sipas formularit e-Sig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Kriteri 2.3.3 dhe nënkomponentët e tij pika a ,b, c,d,e do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet, se “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.3.2. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>

<p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>

B: DEKLARATA
Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
- 6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*
- 7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
 - a) çmimet;*
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
- 8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i

Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punë dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
------------------	------------------

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____</p>
<p>Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kreatx” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të plotësuar nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të plotësuar nga operatori ekonomik “Bledar Meço” Pf;
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK dhe subjektit mbështetës “Bledar Meço” PF, datë 11.01.2024.

III.3.4 Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit në pikën 2.3. 3 “Kapaciteti teknik”, për disponimin e stafit teknik për kryerjen e shërbimit, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kërkuar, që **2.3.3 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 4 (katër) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:**

- a) *Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.*
- b) *Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).*
- c) *Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).*
- d) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.*
- e) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente).*

Gjithashtu, në fund të kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se: “Kriteri 2.3.3 dhe nënkomponentët e tij pika a ,b, c,d,e do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit”.

Operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) ku në Pjesën III, Deklaratën B “deklaron se: Punonjës [Po], Kreatx shpk disponon të paktën 4 (katër) punonjës të diplomuar në shkenca elektronike/teknologji informacioni/informatikë/informatikë ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë.

Profili i punonjësve:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente).

Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në Pjesën I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektin, mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Kreatx” SHPK. Konkretisht, të operatorit ekonomik “Bledar Meço” Pf.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar, që nëse një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor, se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim, për të cilën ka dorëzuar një Deklaratë, datë 11.01.2024, midis operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK dhe operatorit ekonomik “Bledar Meço” PF (subjekt mbështetës), si dhe ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) të operatorit ekonomik “Bledar Meço” PF, ku në Pjesën III, Deklaratën B “deklaron se: Punonjës [Po], nëse po, numri i punonjësve: Ne subjekti “Bledar Meço” PF deklarojmë që jemi subjekt mbështetës për operatorin ekonomik “Kreatx” SHPK për certifikimet e mëposhtme:

Profili i punonjësve:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik “Kreatx” SHPK ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), përkatësisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në pjesën e tretë të tij Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, ka deklaruar numrin e punonjësve si dhe profilet, duke deklaruar të gjitha profilet e kërkuara nga autoriteti kontraktor sipas shtojcës 8, pikës 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të

Vetëdeklarimit, ku në pjesën e tretë të tij *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”*, të plotësuar nga operatori ekonomik Bledar Meço PF, ka deklaruar profilet për të cilat do të mbështesë operatorin ekonomik “Kreatx” SHPK.

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022, protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia e Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] *Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, **plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre**, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...].*

Nisur nga pretendimet e ankimuesit, korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara në pjesën III: *“Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë ‘Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt – kontrate’*”, gjujkojmë, se punonjësit e deklaruar të operatorit ekonomik ankimues dhe atij mbështetës, kanë të evidentuar të dhënat, si numrin e punonjësit, si dhe profilin respektiv të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila, i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt - ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, të nenit 26, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i profilit të punonjësve sipas kërkesave të pikës 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Inet” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur” me Nr. REF-92145-12-26-2023, me objekt “Platforma për aplikimet online, për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe” me fond limit 24,686,667.00 (njëzet e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, sipas vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inet” SHPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

